

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CHECK COMPANY“ sh.p.k.

Në Tiranë, sot më datë 06/06/2024 :

Z FRANCI CANAJ, shtetase Shqiptare, lindur ne Tirane, më 31.03.1993 dhe banues në , Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga e Dibrës, , Banesë Private, Nr.275 Tirane., mbajtese i kartes se identitetit me ID J303310570

Në cilësinë e “ortakut themelues“ ka rene dakort per hartimin e ketij akt themelimi , nëpëmjet të cilit deklarojne se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, **“CHECK COMPANY“ sh.p.k**

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria **“CHECK COMPANY“ sh.p.k.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Pergjegjësi te Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
Shoqëria **“CHECK COMPANY“ sh.p.k.**, është një shoqëri tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë ne: Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga e Dibrës,Banesë Private Nr.275 Tirane
Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nepermjet vendimit vetem nga Administratoret si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Sherbim Taksi. Hoteleri. Marrje dhe dhenie makinash me qira. Bare, resorante.
Çdo aktivitet tjetër qe eshte i lejuar nga ligjet e shtetit Shqiptar.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 100000 Lekë. Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 1 kuotë me vlerë, si me poshte:

Z. FRANCI CANAJ, zoteruese e 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërisë me vlere 100000(njeqind mije) lek

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)
Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakut i vetëm ne rast se shoqëria është e themeluar nga nje ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.



Asambleja e Pergjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) të bleje, shese, kembeje pasuri të patundshme të shoqërisë;
- n) të shpërndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund të kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë është **FRANCI CANAJ, mbajtes i kartes se identitetit J303310570** i emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e

veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) Te hape llogari bankare dhe te operoje për llogari të kompanise pa limit.

f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;

g) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqërisë

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "**CHECK COMPANY**" *sh.p.k*, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.

ORTAKU I VETEMI SHOQERISE
"CHECK COMPANY"

FRANCI CANAJ

Franci Canaj 